

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË DURRES

Nr. 600 Rep.

Nr. 292 / 3 Kol.



KONTRATË

SHIT – BLERJE KUOTASH

Sot, më datë **15/03/2011**, para meje **ALBANA H. HOTI**, Notere e Dhomës së Noterisë Durres, u paraqitën personalisht Shitësi dhe Blerësit, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuotash me termat e mëposhtme:

SHITËSIT: PLATOR MEHMETI, i biri i Qaniut dhe i Teutes, lindur ne Durres me 09.01.1969, banuese ne Durres Lagjen Nr.1 Rr.Anastas Durrsaku Pallati Star, me zotesi te plote per te vepruar, te për identitetin e të cilit u sigurova nga karta e identitetit te tij nr.027825211, i cili ka statusin e ortakut ne masen 90% te kuotave i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “HTM” me objekt tregti me pakice i karburanteve Import-Export, projekte, zbatime ne fushen Elektrike, etj, Regjistruar prane QKR me NIPT K97006004D, status aktiv.

BLERËSIT: ILIR TABAKU, i biri i Iljazit dhe i Fellenxes, lindur ne Durres me 04.09.1984, banuese ne Lagjen Popullore Shijak, me zotesi te plote per te vepruar, te për identitetin e të cilit u sigurova nga karta e identitetit te tij nr.024900295.

OBJEKTI:Shitja e kuotave të shoqërisë “HTM” Sh.p.k. në masën 90% të kapitalit themeltar kuota këto që zotërohen nga ortaku i shoqërisë **Z.PLATOR MEHMETI**, me cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga ortaku tjetër **Z.Illir Tabaku** me cilësinë e blerësit.

PËRMBAJTA E KONTRATËS

Shoqëria Ndertuese “HTM” Sh.p.k. është regjistruar pranë QKR sipas Ekstraktit Historik i Regjistrimit i dates 30.05.2011 me nr. NIPT K97006004D.

Me vendimin e datës 15/03/2012 të Ortakeve të shoqërisë është vendosur shitja e kuotave në masën 90% të nga ana e ortakut të shoqërisë **Z.PLATOR MEHMETI**, dhe blerja nga ana e ortakut **Z. Ilir Tabaku** i cili eshte ortak ne masen 10%, duke u bere ortak i vetem i saj në masën 100%.

Shitja e masës prej 90% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “HTM” Sh.p.k. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë në masën 100% mbi kuotat e kapitalit themeltar të ortakut të shoqërisë **Z.PLATOR MEHMETI**, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e mësipërm të Ortakut të vetëm, datë 13/12/2012.

Shitësi **Z.PLATOR MEHMETI**, është plotësisht dakord të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 90% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë “HTM” Sh.p.k. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit **Z. Ilir Tabaku**, ku përfiton zotërimin e 100% të kuotave.



Blerësi, **Z. Ilir Tabaku**, është plotësisht dakord që të blej me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 90% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "HTM" Sh.p.k.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku i vetëm i shoqërisë **Z.PLATOR MEHMETI** humbet pronësinë në masën 90% të kuotave të zotëruara prej saj në kapitalin themeltar të shoqërisë "HTM" Sh.p.k. ndërsa blerësit **Z. Ilir Tabaku**, bëhen pronar i 100% të kuotave të shitura, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.

Shoqëria Tregtare "HTM" Sh.p.k., pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si ortakë te vetem te saj **Z. Ilir Tabaku** i cili zoteron keshtu 100% kapitalin themeltar.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë "HTM" Sh.p.k. do të jetë shuma prej **90'000 lek**, çmim i cili bazohet në vlerën e kapitalit që ka sot kjo shoqëri, vlerë e cila është likuajduar totalisht nga pala blerese Cash ne Dore Jashte kesaj Zyre Noteriale.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi **Z. Ilir Tabaku**, do të paguajnë në favor të Shitësit **Z.PLATOR MEHMETI**, shumën prej **90'000 lek**, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në gjashtë kopje të njëjta nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termet e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në praninë time.

PALËT

SHITËSI

BLERËSI

NOTERE